




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. _____
Dep. 30
Nr. i faq. _____
Broj stranica _____
Nr. pages 02

Nr. Prot. _____
Bi Prot. _____
Prot No 01-1235/15
Data _____
Datum 08.05.2015
Date _____

PRISTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.05.2015, mori:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02/1001/15, për z. Agron Mustafa, Kryeshef Ekzekutiv i PTK-Sh. A, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshem për ekzistimin e konfliktit të interesit, ne ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se ardhur në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-02/1001/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, z. Agron Mustafa, Kryeshef Ekzekutiv i PTK-Sh. A.

Në kërkesën e berë nga pala e tretë për të vërtetuar gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e lartë, z. Agron Mustafa, Kryeshef Ekzekutiv i PTK-s, dhe gruas së tij Anita Blaka- Mustafa e cila është e punësuar në Departamentin e burimeve njerëzore në këtë kompani.

Duke vepruar sipas kompetencave dhe mandatit që kemi, janë grumbulluar informatat zyrtare të ofruara nga PTK-ja, është krahasuar koha kur janë punësuar, të lartcekurit, kontratat që kanë të nënshkruar me PTK, si dhe lidhja në mes të departamentit të burimeve njerëzore dhe Krye shefit Ekzekutiv të PTK-së.

Me vlerësimin e provave dhe gjendjes faktike të cilën ndodhen zyrtarët e PTK-se z. Agron Mustafa, Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së, dhe znj. Anita Blaka-Mustafa, zyrtare e burimeve njerëzore pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore në PTK-Sh.A, kemi ardhur në përfundim se nuk ka elemente që e dëshmojnë gjendjen e konfliktit të Interesit, pasi që znj. Anita Blaka-Mustafa, ka të nënshkruar kontratën e punës me PTK që nga data 22.03.2012 pra është e punësuar para se të zgjidhët si Kryeshef i Kompanisë bashkëshorti i saj z. Agron Mustafa, andaj munde të themi me përgjegjësi se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me gjendje të konfliktit të interesit, mirëpo zyrtari i lartë është i obliguar që në rast të paraqitjes eventuale të ndonjë situatë me konflikt “rast për rast” të interesit, të bëjë deklarinimin paraprak të interesave private (konform neni 13, paragrafi 1,2,3 të ligjit 04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik).

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

